



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR 344-8304/18

Me 10.12.2018

KONTRATA, KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I: KONTRATA PUBLIKE KORNIZE NR. 109/2018

Komuna Kline, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), Nr. Regjistrat 07000032 dhe Nr. Fiskal 600219366, që përfaqësohet nga Z. Abaz Foniqi – menagjer i z. Prokurimit në njërin dhe

"PBC SHPK" (në vazhdim "Operatori Ekonomik") PRISHTINE me numer biznesi 71131068 dhe nr. Fiskal 601211890 që përfaqësohet nga pronari z. BASHKIM SELMANI

Në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**FURNIZIM – INSTALIM I GPS- TRACKING DEVICE PER
AUTOMJETET E QKMF " NENE TEREZA " KLINE**
me numër Identifikues 634-18-8744-136/634-18-115-136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë kontratë publike

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë dërgesa, nga Furnizuesi INSTALIM – TRAJNIM DHE MIERMBAJTJE piken furnizuese – të A.K. i furnizimeve në vijim:

NR.	Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi per një	Vlera me t
1	GPS – TRACKING DEVICE – FURNIZIMI DHE INSTALIMI	COPE	6	87.00	522.50
2	TAJNIM I PERDORUESEVE	PERSON	2	34.22	68.44
3	MONITORIMI	MUAJ	12	8.26	99.12

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të MENJEHERE me të marre porosinë me urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2. Kontrata hyne n fuqi me date 05.12.2018 .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë KLINE.

2.3 Inkotermi¹ i zbatueshëm do të jetët *DDP Kline*

Neni 3

Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.- edhe ne Specifikacioni Teknik te Dorzuar me oferte qe eshte pjese integrale e kësaj kontrate .

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4

Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: = 690.06 €;

(Gjashteqindenenetdhjeteuroe06/100 euro)

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3. Furzimiet duhet te jene sipas specifikacionit teknik te dhene ne Oferte .

4.4. Paisjet duhet te Percillen me flete garancion dhe Spaecifikimet teknike .

4.5 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.6 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.Me te pranuar te Paisjeve dhe Me raport nga Pranimi i mallrave dhe fatures .

Neni 5

Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹ Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

(e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE ² në kater origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues	Komuna Kline	Për Furnizuesin	PBC SHPK _ PRSHTINE
Emri:	ABAZ FONIQI	Emri:	<u>Bashkim Selmani</u>
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Vula: dhe data	 10.12.2018	Data:	 10.12.2018

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.